



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË

SEKTORI JURIDIK PROKURIMEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 11446 / Prot. 8

Divjakë, më 14.11.2025.

PROJEKT -- VENDIM

Nr. 78 datë 14.11.2025.

“MBI MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS, DREJTORIA VENDORE LUSHNJE, PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT”.

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 , datë 17.12.2015 “ *Për Vetëqeverisjen Vendore* ”, (i ndryshuar), me VKM nr. 97 datë 03.02.2008, “ Për procedurat e privatizimit të banesave shtetërore objekt i Ligjit nr. 7652 datë 23.12.1992 dhe Ligjit nr. 9321 datë 25.11.2004 “ Për trajtimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa me fondet e Shoqërive dhe Ndërmarrjeve Shtetërore “, pika 5, pika 27 dhe 37 nenet 1 dhe 2, VKM numër 179, datë 26.02.2020, “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subject i Ligjit 7652, datë 23.12.1992, “Për Privatizimin e Banesave Shtetërore”, si dhe në Dekretin e Presidentit nr. 1440 datë 04.04.1996 “ Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara neni 1 dhe neni 2 , si edhe neni 192 i Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë paragrafi II , regjistrimi i Pasurive të Paluajtshme të bëhet në bazë të një akti public , të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent , si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj , si edhe neni 193/b i Kodit Civil, i propozojme Bashkisë Divjakë, me datë 25.11.2025:

1- Të miratojë përfundimin e procedurës së privatizimit te banesave te cilat kane mbetur pa u regjistruar prane Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme per lidhjen e kontratave para noterit per qytetaret qe kane aplikuar sipas listes se meposhteme emerore :

- **Ilmi Zejfulla Marina**, lindur në Sulzotaj, Lushnje dhe banues në Shënepremte, me adresë Shenepremte, ndertesa numer 6, hyrja 1, Apartamenti 1, Shënepremte , ka aplikuar dhe ka paraqitur dokumentacionin përkatës për apartamentin e ndodhur në Pallatin numër 7 Sulzotaj, Shk --, Kati i I e perbere nga 1 dhoma dhe 1 kuzhine, me aneks në fshatin Shënepremte, Zona Kadastrale 3341, i gjithë dokumentacionin ndodhet në dosjen e privatizimit.

Juristi

Andi Bullari

KRYETARI

JOSIF GORREA

